



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1990/prot.
3

Tiranë, më 18/05/2020

URDHËR

Nr. 328, datë 18 .05 .2020

“PËR DISA SHTESA NË URDHËRIN NR.279, DATË 25.04.2020 “PËR LEHTËSIMIN E POSAÇËM TË LËVIZJES NË “ZONAT E GJELBËRTA” TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 7, të Ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik si dhe Vendimit nr. 2357 datë 16.05.2020 të Komitetit të Përkohshëm për infeksionin e përhapur nga coronavirusi i ri, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në Urdhrin Nr. 279 datë 25.04.2020 “Për lehtësimin e posaçëm të lëvizjes në “Zonat e Gjelbërta”, të ndryshuar, bëhet shtesa dhe ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1, pas fjalës “Peqin” shtohet fjala “Fier”.
2. Pika 2 dhe pika 3 shfuqizohen.
3. Në pikën 6 togfjalëshi “nga ora 09:30 deri në orën 21:30” shfuqizohet.
4. Pika 6/1 shfuqizohet.
5. Çdo parashikim i mëparshëm që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

